



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 142 Akti

**Nr. 233 Vendimi
Tiranë, më 3.2.2020**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në datën 3.2.2020, në Pallatin e Koncerteve salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore për t'i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar në lidhje me kërkesën për dorëheqje, si çështje e cila do të sillte pasoja të drejtpërdrejta mbi statusin e saj ligjor.

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Elona Kana**, këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b**, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni G, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi mori në shqyrtim kërkesën e dorëheqjes së paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, nga vijimi i procesit dhe dokumentacioni nga institucionet shtetërore diskutoi mbi tërësinë e çështjes,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), znj. Elona Kana ushtronte detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë dhe në bazë të nenit 179/b/4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit, për shkak të statusit të saj, *ex officio*, si këshilltare ligjore e Gjykatës së Lartë.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, u shortua në shortin e hedhur në datën 15.5.2018, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” – nga i cili rezultoi se do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Suela Zhegu dhe Xhensila Pine. Me mirëkuptim, kryesuese e trupit gjykues u caktua komisionere Suela Zhegu. Anëtarët deklaruan mungesën e konfliktit të interesit.
3. Komisioni, me anë të komunikimit nëpërmjet postës elektronike, njoftoi subjektin e rivlerësimit se ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar në përputhje me nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe i bëri me dije përbërjen e trupit gjykues, për të cilin subjekti nuk deklaroi konflikt interesi.
4. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana, iu nënshtrua testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës dhe pasi mori mbi 60 % të pikëve në këtë testim, filloi programin e trajnimit 2-vjeçar, sipas parashikimeve të nenit 165, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 96/2016).
5. Në datën 25.9.2018, znj. Elona Kana, iu drejtua kryetarit të Gjykatës së Lartë, me kërkesën për të disponuar për marrëdhënien aktuale të punës së saj në kushtet kur i kishte lindur e drejta për të ndjekur Shkollën e Magjistraturës dhe për fitimin e statusit të magjistratit, bazuar në pikat 1 dhe 4, të nenit 165, të ligjit nr. 96/2016.
6. Kryetari i Gjykatës së Lartë, bazuar në kërkesën e znj. Elona Kana, nxori urdhrin nr. ***, datë 25.9.2018, për përfundimin e marrëdhënies së punësimit me afat të këshilltares ligjore, znj. Elona Kana, dhe ndërprerjen e marrëdhënies financiare me Gjykatën e Lartë në datën 1.10.2019, në mbështetje të pikave 1 dhe 4, të nenit 165, të ligjit nr. 96/2016.
7. Komisioni vijoi hetimin administrativ për subjektin Elona Kana dhe me vendimin nr. 2, datë 10.7.2019 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Kana; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me Kodin e Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzonte për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, brenda datës 21.7.2019.
8. Nëpërmjet postës elektronike të datës 17.7.2019, subjekti Elona Kana i kërkoi trupit gjykues shtyrjen e afatit me të paktën 20 ditë, si shtyrje e domosdoshme, pasi për të gjitha gjetjet e dërguara me barrën e provës i duhej të mblidhte prova të mëtejshme pranë autoriteteve kompetente dhe do t’i duhej të paraqiste kërkesa për prova dhe dëshmitarë, të cilat kërkonin me patjetër kohë në kuadër të një procesit të rregullt ligjor.

9. Në datën 18.7.2019, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të pranojë kërkesën e znj. Elona Kana, në respektim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për t'i dhënë kohën e mjaftueshme për përgatitjen e provave dhe të shpjegimeve për barrën e provës së kaluar nga Komisioni, duke shtyrë afatin e përcaktuar nga data 21.7.2019 në datën 29.8.2019.
10. Pas administrimit të shpjegimeve dhe provave të dërguara nga subjekti, në zbatim të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, duke konsideruar edhe kërkesën për pamundësi paraqitjeje në seancën dëgjimore nga data 27 deri më 30 shtator 2019, trupi gjykues me vendimin nr. 4, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Kana, në seancën dëgjimore që do të zhvillohej në datën 2.10.2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B.
11. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, në datën 28.9.2019, konfirmoi marrjen e njoftimit duke kërkuar që në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, t'i vihej në dijeni para seancës qëndrimi i Komisionit përkundrejt kundërshtimeve të saj, si dhe të ribëjë analizën financiare dhe raportin paraprak për t'i mundësuar një mbrojtje efektive.
12. Trupi gjykues arsyeton se analiza finale për subjektet e rivlerësimit bëhet pas zhvillimit të seancës dëgjimore publike, e cila konsiderohet si mundësia dhe garancia e parashikuar nga ligji, në të cilën subjekti i rivlerësimit ushtron të drejtën për t'u dëgjuar nëpërmjet parashtrimit të argumenteve ligjore mbi rezultatet e arritura nga Komisioni, në këndvështrim edhe të provave të reja, të cilat mund të paraqiten gjatë kësaj seance, si mundësi ligjore për të paraqitur në këtë fazë finale provat, që nuk janë paraqitur gjatë hetimit administrativ.
13. Në datën 2.10.2019, subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, në fillimin e seancës dëgjimore paraqiti kërkesën për përjashtimin e relatores së çështjes bazuar në nenet 72 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Pas marrjes së kërkesës, seanca u ndërpre me qëllim shqyrtimin nga një trup tjetër gjykues, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
14. Me vendimin nr. ***, datë 2.10.2019, të mbledhjes së Komisionit u shortua trupi gjykues, i cili pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, për përjashtimin e relatores, me vendimin nr. *** prot., datë 4.10.2019, e rrëzoi atë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ky vendim iu njoftua trupit gjykues dhe subjektit të rivlerësimit.
15. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, u njoftua në datën 8.10.2019 se seanca dëgjimore do të vijonte në datën 10.10.2019, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B.
16. Në datën 9.10.2019, subjekti Elona Kana i bëri me dije Komisionit dorëheqjen e datës 4.10.2019 nga vijimi i mëtejshëm i procesit akademik/praktik në Shkollën e Magjistraturës, drejtuar Këshillit Drejtues, nëpërmjet komunikimit elektronik dhe protokollit institucional.
17. Trupi gjykues, pas marrjes dijeni të kërkesës për dorëheqje të subjektit, vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore të planifikuar për datën 10.10.2019, për të kërkuar informacion dhe dokumentacion nga institucionet përkatëse, për të bërë të mundur studimin e plotë të rrethanave dhe kushteve të dorëheqjes, si dhe përcaktimin e situatës ligjore aktuale të subjektit të rivlerësimit.
18. Komisioni, në datën 9.10.2019, njoftoi subjektin e rivlerësimit për shtyrjen e seancës dëgjimore të planifikuar për datën 10.10.2019, duke i bërë me dije se ka administruar dokumentacionin e paraqitur dhe se pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni do t'i bëjë me dije vijimin e procedurës së rivlerësimit. Komisioni i kërkoi informacion institucioneve, si më poshtë:
19. Me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2019, u kërkua informacion në Gjykatën e Lartë lidhur me dokumentacionin e znj. Elona Kana, përfshirë praktikën e datës 25.9.2018.

20. Me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2019, u kërkua informacion në Shkollën e Magjistraturës në përgjigje të së cilës, me shkresën nr. *** prot., datë 4.11.2019, Komisioni u vu në dijeni për urdhrin nr. ***, datë 14.10.2019, të Drejtorit të Shkollës, ku urdhërohej ndërprerja e marrëdhënieve financiare për znj. Elona Kana, nga data 4.10.2019, dhe për shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, nëpërmjet së cilës Shkolla e Magjistraturës vuri në dijeni dhe dërgoi pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana.
21. Trupi gjykues, duke vlerësuar se në krye të Shkollës së Magjistraturës qëndron këshilli drejtues, si organi më i lartë që drejton dhe kontrollon kolegjisht gjithë veprimtarinë akademike administrative dhe financiare të Shkollës, kërkoi informacion për sa këshilli drejtues i Shkollës së Magjistraturës do të shprehej në mbledhjen e janarit 2020, lidhur me dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana (në referim të njoftimit nga Shkolla e Magjistraturës se mbledhja e këshillit ishte mbajtur në 3.10.2019 e mbledhja e radhës do të ishte pas 3 muajsh).
22. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës bazuar në relacionin nr. *** prot., datë 27.1.2020, të drejtorit të shkollës, ku kërkohet vendimmarrja e këshillit për pagesat e përfituara gjatë trajnimit dyvjeçar, ndër të tjera, për znj. Elona Kana e cila kishte paraqitur dorëheqjen nga vijimi i procesit të shkollimit në Shkollën e Magjistraturës, mori vendimin nr. ***, datë 28.1.2020 për studentët që nuk detyrohen të kthejnë pagesat e përfituara gjatë trajnimit. Vendimi iu bë me dije Komisionit në datën 31.1.2020 dhe në të njëjtën ditë iu dërgua subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, në adresën e komunikimit të saj zyrtar me Komisionin.
23. Trupi gjykues me shkresën nr. *** prot., datë 16.12.2019, kërkoi nga mbledhja e Këshillit të Lartë Gjyqësor miratimin e dorëheqjes së dhënë nga subjekti rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana, bazuar në germën “i”, të nenit 2, të ligjit nr. 96/2016, ku përcaktohet se: “*Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi që merret me çështje që lidhen me gjyqtarët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magjistratë, që ndjekin Shkollën e Magjistraturës, me qëllim që të behën gjyqtarë*”, duke i bërë me dije se ky miratim ishte një procedurë e domosdoshme për t’u kryer në kuadër të parashikimeve të pikës 3, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, mungesa e të cilës, do ta vendoste Komisionin në tejkalim të kompetencave ligjore.
24. Me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor informoi Komisionin:

Në kushtet kur znj. Elona Kana ka ndërprerë marrëdhënien juridike të punësimit si ndihmëse ligjore/këshilltare ligjore (jomagjistrate) në Gjykatën e Lartë në datën 1.10.2018, pra, përpara krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (datë 12.12.2018), si dhe kur për përfundimin e kësaj marrëdhënieje është shprehur organi publik që ka vijuar të ushtrojë kompetencat e organit të emërtesës për këtë kategori të punësuarish deri në krijimin e Këshillit, ky i fundit nuk ka detyrimin dhe as mund të shprehet për këtë çështje, tashmë ligjërisht të trajtuar/mbyllur.

Për sa i përket ndërprerjes së programit të trajnimit dyvjeçar në Shkollën e Magjistraturës për shkak të dorëheqjes së kandidates për magjistratë, znj. Elona Kana, është shprehur Shkolla e Magjistraturës, pra, institucioni publik i ngarkuar nga ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (neni 244), me funksionin e sigurimit të formimit profesional të magjistratëve.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

II/1 Orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

25. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në lidhje me praktikën e shqyrtimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi i rivlerësimit në faza të ndryshme

të tij, orienton Komisionin që për zgjidhjen e kësaj çështjeje, duhet verifikuar vullneti i pavesuar për dorëheqjen e dhënë, nëpërmjet miratimit të tij nga një prej institucioneve të caktuara me ligj, nisur nga pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit.

26. Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

II/2 Verifikimi i statusit ligjor të subjektit dhe vullnetit të pavesuar për dorëheqje

27. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti Elona Kana ushtronte detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë dhe dispozitat kushtetuese që prezantuan konceptin e rivlerësimit dhe parimet e tij, përcaktohej shprehimisht se subjekti i rivlerësimit, duhet t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, si këshilltare ligjore e Gjykatës së Lartë.
28. Trupi gjykues, pas administrimit të dokumentacionit nga Gjykata e Lartë kreu një vlerësim tërësor të procedurës, në kuadër të dispozitave materiale dhe procedurale, si më poshtë.
29. Me urdhrin nr. ***, datë 31.10.2012, të kryetarit të Gjykatës së Lartë, bazuar në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë", znj. Elona Kana është emëruar këshilltare ligjore e gjyqtarës M.A.;
30. Me urdhrin nr. ***, datë 16.9.2016, të kryetarit të Gjykatës së Lartë, znj. Elona Kana është emëruar në detyrën e këshilltares ligjore të gjyqtarit A.Z., marrëdhënie e rregulluar me kontratën nr. *** prot., datë 19.9.2016, neni 2 i së cilës përcaktonte marrëdhënien e punësimit të znj. Elona Kana, si marrëdhënie me afat të caktuar, deri në mbarimin e mandatit të gjyqtarit me të cilin ajo punonte.
31. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, me kërkesën nr. *** prot., datë 25.9.2018, pas fitimit të së drejtës për të vijuar trajnimin 2-vjeçar në Shkollën e Magjistraturës i kërkoi Kryetarit të Gjykatës së Lartë: *"të disponojë për marrëdhënien aktuale të punës në kushtet kur i kishte lindur e drejta, për shkak të kalimit me sukses të testimit të aftësive profesionale, në bazë të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, të ndjekë Shkollën e Magjistraturës dhe të fitojë statusin e magjistratit"*.
32. Urdhri nr. ***, datë 25.09.2018, i kryetarit të Gjykatës së Lartë dalë në vijim të kësaj kërkesë nuk mund të dispononte për statusin e këshilltares ligjore, pasi në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, jo vetëm që ushtronte detyrën si këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë, por ishte edhe në proces rivlerësimi, pikërisht për shkak të këtij pozicioni, çka bënte që deri në përfundim të procesit të rivlerësimit, të ishte imperative që pozicioni i saj të mos ndryshonte për asnjë shkak përveçse atij të mbarimit të statusit.
33. Ky fakt u konfirmua edhe me rrethanat faktike kur pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, me vendimin nr. ***, datë 18.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përfundoi mandati i gjyqtarit me të cilin punonte dhe kjo rrethanë nuk solli asnjë pasojë të marrëdhënies e punësimit të znj. Elona Kana (duke konfirmuar se marrëdhënia me afat e referuar në urdhrin e kryetarit të Gjykatës së Lartë nuk kishte më fuqi ligjore për palët).
34. Trupi gjykues, pas vlerësimit dhe analizimit tërësor të procedurës së ndjekur nga palët si më sipër analizuar, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana, vijoi të gëzojë statusin e këshilltares ligjore në vijimësi, si dhe gjatë trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, duke vijuar të jetë objekt i veprimit të nenit 179/b, pika 4, e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

35. Urdhri nr. ***, datë 25.9.2018, i kryetarit të Gjykatës së Lartë bëri të mundur sa iu referua Komisionit me shkresën e datës 27.9.2018, të Shkollës së Magjistraturës se subjektet e rivlerësimit, *ex officio*, në ditën e nënshkrimit të aktmarrëveshjes me Shkollën e Magjistraturës dhe fillimit të programit mësimor në datën 1 tetor 2018, detyroheshin sipas ligjit të ndërpresin marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionet ku punojnë, për të frekuentuar rregullisht programin dhe për të respektuar rregulloren e shkollës.
36. Ky konkluzion i trupit gjykues bazohet edhe në sa dispozitat kalimtare të ligjit nr. 96/2016, përcaktuan raportin e ndërlidhur midis statusit të këshilltarit ligjor, procesit të rivlerësimit kalimtar dhe trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, duke i lidhur ato në mënyrë konceptuale me dispozitat kalimtar të nenit 165, të ligjit nr. 96/2016, si më poshtë vijon:
- ✓ Pika 8, ku përcaktohet se nëse institucioni për rivlerësimin do të merrte vendim për masën e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, *ex officio*, i cili vetohej në funksionin e këshilltarit ligjor, do të ndërpritej edhe programi i trajnimit dhe subjekti do të përjashtohej nga ky program.
 - ✓ Pika 2, ku përcaktohet se këshilltari ligjor vazhdon të qëndrojë në detyrë, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar.
 - ✓ Pika 4, germa “c”, ku përcaktohet se pagesa e kësaj kategorie studentësh gjatë kohës së shkollimit ishte e njëjtë me pagën e marrë para trajnimit nga kjo kategori studentesh, subjekte të rivlerësimit, *ex officio*, në ndryshim nga studentët e tjerë të shkollës.
37. Në analizë, për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se viti i parë i shkollimit teorik edhe praktika/stazhi në vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, janë veprimtari të kryera për shkak të statusit, *ex officio*, si këshilltar ligjor, që ajo gëzonte.

II/3 Ftesa për seancë dëgjimore dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

38. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, dhe orientimin e dhënë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin nr. 17/2019 (JR), verifikoi rastet përjashtimore të zbatimit të dispozitës mbi thirrjen në seancë dëgjimore, përcaktuar në mënyrë shteruese në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative.
39. Trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk plotësohej asnjë prej rasteve përjashtimore të parashikuara në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilave procedura administrative mund të mbyllet pa i dhënë mundësinë subjektit për t’u dëgjuar lidhur me kërkesën e saj dhe, për rrjedhojë, mosmbajtja e seancës dëgjimore do ishte në kundërshtim me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.
40. Për sa më sipër, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana, në seancën dëgjimore të datës 30.1.2020, ora 12:00, duke e njoftuar atë për orën e datën e seancës dhe duke i bërë me dije se kjo seancë do të mbahej për t’i dhënë mundësinë subjektit për t’u dëgjuar në lidhje me kërkesën e paraqitur për dorëheqje, si çështje e cila do të sillte pasoja të drejtpërdrejta mbi statusin e saj ligjor.
41. Në datën 28.1.2020 përmes postës elektronike subjekti i rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana, konfirmoi marrjen e njoftimit dhe kërkoi shtyrjen e seancës, pasi për arsye objektive e kishte të pamundur të ishte e pranishme deri në datën 2.2.2020, por edhe për arsye të heshtjes së Komisionit për një periudhë 3-mujore, si dhe njoftoi Komisionin se mbetej në pritje të caktimit të një afati tjetër.

42. Trupi gjykues vendosi të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, znj Elona Kana, për shtyrje të seancës, pavarësisht se nuk u provuan prej saj shkaqet objektive për mosprezencën, duke i bërë me dije subjektit Elona Kana se kjo periudhë i ishte dashur trupit gjykues për verifikimin e dorëheqjes, saktësimin e natyrës specifike të statusit që gëzonte dhe cilësimin e saktë të situatës ligjore në të cilën subjekti ndodhej. Në referencë të nenit 22/b, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, trupi gjykues vendosi dërgimin nëpërmjet *e-mail*-it të skanimit të gjithë komunikimit me institucionet gjatë kësaj periudhe, duke i bërë me dije, nëse e vlerësonte të arsyeshme, se kishte të drejtën në ditët në vijim të paraqitjes për të marrë kopje fizike të dokumentacionit.
43. Komisioni njoftoi shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 30.1.2020, ora 12:00, për arsye objektive në datën 3.2.2020, ora 13:00, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Komisionit.
44. Komisioni njoftoi këtë shtyrje të seancës dëgjimore nëpërmjet komunikimit me anë të postës elektronike në datën 29 janar 2020, duke verifikuar dhe administruar, sa vijon:
- ✓ konfirmimin e mbërritjes në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana, në datën 29.1.2020, ora 17:26, të njoftimit për shtyrjen e seancës dëgjimore dhe të dokumentacionit të korrespondencës së Komisionit me institucionet, dërguar bashkëlidhur njoftimit;
 - ✓ konfirmimin e mbërritjes në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana, në datën 31.1.2020, ora 16:59, të vendimit nr. ***, datë 28.1.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

II/4 Ligji i zbatueshëm dhe arsyet për ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit

45. Neni G, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: “1. *Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.* 2. *Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*”.
46. Pika 3, e nenit 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative, përcakton se: “*Diskrecioni i organit publik është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.*”, ndërsa nenet 11 dhe 100/ç të ligjit nr. 44/2015, përcaktojnë detyrimet e Komisionit në këtë rast.
47. Dispozitat kalimtare të nenit 165, të ligjit nr. 96/2016, parashikojnë se: “2. *Këshilltari ligjor vazhdon të qëndrojë në detyrë përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar*”.
48. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, arsyeton: “*Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës*”.
- Trupi gjykues vlerëson se rrethanat e situatës faktike në të cilat ndodhet Komisioni, janë:
49. Komisioni verifikoi shprehjen e vullnetit të pavesuar nga subjekti i rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana, për dorëheqjen e dhënë nëpërmjet konfirmimit të paraqitjes së dhënies së dorëheqjes në Shkollën e Magjistraturës dhe hapave të ndërmarrë nga kjo shkollë.

50. Për sa i përket miratimit të këtij vullneti nga institucioni i caktuar me ligj, Komisioni nisur nga pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, dhe bazuar në germën “i”, të nenit 2, të ligjit nr. 96/2016, ku përcaktohet: “*Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi që merret me çështje që lidhen me gjyqtarët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magistratë që ndjekin Shkollën e Magjistraturës, me qëllim që të behën gjyqtarë*”, kërkoi miratimin e kësaj dorëheqjeje nga organi i caktuar me ligj (në këtë rast KLGJ-ja).
51. Fakti që kjo dorëheqje nuk u miratua nga organi kompetent i caktuar me ligj, Këshilli i Lartë Gjyqësor, brenda afatit kohor, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 70/3, të Kodit të Procedurave Administrative, përbën një rrethanë faktike që nuk mund të ndikojë mbi vendimin për pushimin e procesit të rivlerësimit, referuar edhe arsyetimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimin nr. 17/2019(JR), paragrafët 18 dhe 20.
52. Dispozitat kalimtare të ligjit nr. 96/2016, në nenin 165, parashikojnë: “2. *Këshilltari ligjor vazhdon të qëndrojë në detyrë përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar*”. Vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, sipas përcaktimit në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016, nga subjekti i rivlerësimit, *ex officio*, znj. Elona Kana, do të shprehej vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit.
53. Trupi gjykues i dha mundësinë subjektit të shprehej mbi dorëheqjen dhe pasojat e mundshme që kjo dorëheqje do të kishte mbi statusin e saj ligjor, sipas përcaktimit në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016.
54. Subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur të mos paraqitet në seancën e njoftuar, duke hequr dorë nga mundësia për të paraqitur shpjegime në lidhje me kërkesën për dorëheqje apo për dhënien e shpjegimeve në lidhje me pasojat e drejtpërdrejta mbi statusin e saj ligjor.
- Trupi gjykues, referuar rrethanave të mësipërme, arsyeton se:
55. Dorëheqja nga praktika/stazhi në vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit vazhdonte të gëzonte statusin e këshilltares ligjore të Gjykatës së Lartë dhe për sa kohë procesi i rivlerësimit për të nuk kishte përfunduar ende konsiderohet nga trupi gjykues si tërheqje nga statusi i këshilltares ligjore, tërheqje nga detyra dhe heqje dorë nga procesi i rivlerësimit.
56. Në këtë moment procedural kjo dorëheqje passjell mungesën e kompetencës së Komisionit, për të vijuar procesin e rivlerësimit qëllimi i të cilit realizohet nëpërmjet konfirmimit apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
57. Përderisa kryerja e procesit të rivlerësimit është kompetencë e Komisionit edhe ndërprerja e këtij procesi, si pasojë e ekzistencës së shkakut ligjor të parashikuar shprehimisht në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës (dorëheqja nga detyra e subjektit të rivlerësimit) është kompetencë kushtetuese dhe ligjore e tij, në kushtet kur është përmbushur kriteri kohor, sipas të cilit dorëheqja është dhënë përpara përfundimit të procesit të rivlerësimit.
58. Zgjedhja nga Komisioni në këtë rast bëhet për të arritur objektivin e caktuar me ligj të kryerjes së procesit të rivlerësimit në përputhje me parimet e përgjithshme të legjislationit në fuqi, si dhe nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra në raste të njëjta apo të ngjashme të dorëheqjeve të subjekteve të rivlerësimit nga detyra gjatë këtij procesi.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 179/b, pika 4, e Kushtetutës dhe nenin G, të Aneksit të Kushtetutës, në pikën 3, të nenit 3, të ligjit nr. 44/2015, në ligjin nr. 84/2016, në dispozitat kalimtare të ligjit nr. 96/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”.

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Kana, është ndërprerë.
 2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.
 3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
 5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në datën 3.2.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela Zhegu

Kryesuese

Olsi Komici

Anëtar

Xhensila Pine

Relatore

Gledis Hajdini
Sekretare Gjyqësore